



QENDRA PËR SHËRBIME STUDENTORE DHE KARRIERË

KONKURS PËR BURSA ME QËNDRIM TË SHKURTËR VEROR NË ITALI

Qeveria italiane për viti akademik 2010/2011 ndanë 30 bursa mujore, të cilat duhet të shfrytëzohen përgjatë periudhës verore, ndërsa janë të destinuar për mësim të gjuhës dhe kulturës italiane në Universitetet për të huaj në Perugia dhe Siena.

- **26 bursa** mujore të destinuar për studentët e Fakulteteve Filologjike – (katedra e gjuhës dhe letërsisë italiane)
- **4 bursa** mujore të destinuar për studentët e Fakulteteve të Arkitekturës, Mjekësisë, Farmacisë dhe Shkencave natyrore

Kushtet e konkurrimit:

- aplikuesit duhet të jenë shtetas të RM-së
- të kenë të regjistruar vitin e tretë akademik të studimeve - për studentët e **italianistikës**
- për studentët të arkitekturës dhe shkencave natyrore të jenë studentët të rregullt në vitin e dytë apo tretë të studimeve, ndërsa për studentët e mjekësisë dhe farmacisë duhet të jenë studentët të rregullt në vitin e katërt akademik

Kriteret e përzgjedhjes së aplikantëve:

- nota mesatare e provimeve të gjuhës italiane (vetëm për studentët e filologjikut)
- nota mesatare e të gjithë provimeve (për të gjithë studentët)
- certifikatë për njohje të gjuhës italiane (për studentët tjerë)
- të mos jenë shfrytëzues të bursave tjera nga shteti italian

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- formular shumë-gjuhësor i cili mund të shkarkohet nga ueb-adresa: <http://borseonline.esteri.it/borseonline> i cili duhet të plotësohet dhe të përcjelljet me një dokument identifikimi të skanuar, dhe të dorëzohet në formë elektronike deri më datë **31 MARS 2010**. Formulari në formë të fortë (letre), me datë të shënuar dhe fotografi të formatit të letërnjoftimit, me dokumentacionin e kompletuar duhet të drejtohet deri të **Ambasada e Italisë në Shkup**, rruga: **“8-ma Udarne Brigada”**, Nr: **22, 1000 Shkup**, më së voni deri më **09 PRILL 2010**
- certifikatë për dhënien e të gjithë provimeve, të shoqëruar me notat e lëndëve dhe certifikatë për notën mesatare. Certifikatë që dëshmon se studenti ka të regjistruar semestrin e fundit universitar
- fotokopje e pasaportës apo letërnjoftimit. Certifikatë të nënshtetësisë të RM-së
- certifikatë për ndjekjen e kurseve nga gjuha italiane (për studentët të drejtimeve: arkitekturë, mjekësi, farmaci dhe shkencave natyrore)